



VENDIM

Nr.120, Datë 21.07.2016

MBI

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “REKA ENERGY” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC –ET “ZAJE” ME FUQI TË INSTALUAR 220 KW, “TURAJ” ME
FUQI TË INSTALUAR 320 KW, “XHAFERAJ-MESHTEKEN” ME FUQI
TË INSTALUAR 3680 KW, “NOVOSEJ” ME FUQI TË INSTALUAR 220
KW, DHE “KOLLOVOZ” ME FUQI TË INSTALUAR 1500 KW, ME
FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5940 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 21 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.07.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “REKA ENERGY sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për licensimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “REKA ENERGY” sh.p.k., plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave , miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 108, datë 09.09.2008, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “REKA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Zaje” me fuqi 220 KW, “Turaj” me fuqi 320 KW, “Xhaferaj-Meshteken” me fuqi 3680 KW, “Novosej” me fuqi 220 KW, “Kollovoz” me fuqi 1500 KW, me fuqi totale të instaluar 5940 KW, për një afat 30- vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.